

Irena Prici, mban rolin e Drejtoreshës së Politikave për Artin dhe Kulturën në ministrinë e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, duke vazhduar angazhimin e saj në promovimin dhe zhvillimin e kulturës shqiptare. Në të njëjtën kohë, është e angazhuar si koordinatore për të drejtën e informacionit dhe anëtare e jurive për festivalin TIFF dhe Fondin e Përkthimit.

Diplomuar në “Shkenca Komunikimi” dhe diplomë në Gjuhë-Letërsi në Universitetin e Tiranës. Ajo ka marrë pjesë në shumë trajtime dhe aktivitete të ndryshme, përfshirë trajnime online të organizuara nga Departamenti i Administratës Publike dhe aktivitete të ndryshme që promovojnë integrimin e Shqipërisë në Bashkimin Evropian.

Ka filluar karrierën e saj si gazetare për çështje kulturore dhe sociale në Televizionin Publik Shqiptar (TVSH) nga Qershori i vitit 2005 deri në Prill të vitit 2007.

Në Dhjetor 2007, ajo u emërua zëdhënëse shtypi në Ministrinë e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, një rol që e mbajti deri në Dhjetor 2009, ku më pas vazhdoi si përgjegjëse e sektorit të marrëdhënieve me publikun dhe zëdhënëse shtypi në të njëjtën ministri për disa vite të tjera.

Ka treguar angazhim të jashtëzakonshëm në zhvillimin e politikave kulturore duke u bërë pjesë e Bordit Drejtues të Agjencisë së Lajmeve “News of Albania” që nga Shkurt 2009, dhe më vonë si specialiste në Drejtorinë e Krijimtarisë së Fjalës dhe Përkthimit, dhe në Drejtorinë e Programeve të Zhvillimit të Kulturës. Ajo u emërua përgjegjëse për sektorin e politikave dhe strategjive të kulturës në Ministrinë e Kulturës nga viti 2019 deri në Shtator 2022, ku vazhdoi karrierën e saj si drejtoreshë e komanduar e politikave dhe strategjive të zhvillimit kulturor.

Si ekspert i fushës së komunikimit dhe projekteve në art dhe kulturë, Irena ka organizuar disa aktivitete kulturore ndërkombëtare dhe ka qenë pjesë e stafit organizator të festivaleve folklorike në Gjirokastër. Ajo vazhdon të kontribuojë në fushën e saj me pasion dhe përkushtim, duke e bërë atë një figurë të rëndësishme në zhvillimin e kulturës shqiptare.